



**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ANONIME ME EMERTIMIN**

**“PETROL GAZ”SH.A.**

Sot me daten, zoterinjte e poshteshenuar:

*Adrian Çela*, biri *Syrjait*, dl.1968, lindur dhe banues ne Gjirokaster,

*Albert Kaçi*, biri *Kristaqit*, dl.1967, lindur dhe banues ne Gjirokaster

*Kostandinos Farmaçis*, biri *I Theofilaktos*, dl.1963, lindur dhe banues ne

Janine, Greqi.

ne baze te Ligjit 7638 dates 19.11.1992 “*Per shoqerite Tregetare*” dhe Ligjit 8540, dates 24.02.1999 “*Per perpunimin, transportimin dhe tregetimin e gazit dhe nenprodukteve te tyre*”, me vullnetin e tyre te lire, vendosin hartimin e aktit te themelimit me permbajtje si me poshte vijon:

***Neni 1***

Krijohet shoqeria anonime me emertimin “PETROL GAZ” sh.a. per te ushtruar veprimtari private sipas objektit te saj parashikuar ne kete akt themelimi.

***Neni 2***

Objekti I veprimtarise se shoqerise eshte Tregeti import export, tregeti me shumice e pakice e hidrokarbureve, e gazit te lenget, servis per pajisjet e gazit, prodhim bombola gazi.

***Neni 3***

Selia, qendra e veprimtarise se shoqerise do te jete ne Jergucat, Gjirokaster.

***Neni 4***

Pjesmarrësit ne kete shoqeri anonime me cilesine e aksionereve ,me kontributet e percaktuara sipas certifikates se mbajtesit te fondeve jane;

1. *Adrian Çela*, 33.33% 2. *Albert Kaçi* 33.33% 3. *Kostandinos Farmaçis* 33.34%

***Neni 5***

Kapitali themeltar I shoqerise eshte 2.000.000leke. Ai perbehet nga aksionet, te cilat kane nje vlefte nominale prej 20.000 leke.

***Neni 6***

Sipas kontributeve te aksionereve, percaktohet edhe ndarja e fitimeve nga aktiviteti I shoqerise. Aksioneret e shoqerise perballojne humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se kontributit me aksione ne krijimin e kapitalit themeltar.

***Neni 7***

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise anonime eshte 15 vjet.

***Neni 8***

Shoqeria anonime “PETROL GAZ”, eshte shoqeri pa oferte publike.

***Neni 9***

Organi me I larte I shoqerise eshte Asambleja e Aksionereve. Jane te vlefshme vendimet e saj nese ato merren me pjesemarrjen e jo me pak se 2/3 e mbajtesve te aksioneve. Ne mbledhjen e Asamblese se Aksionereve, marrin pjese aksioneret ose perfaqesuesit e tyre me akt te vecante perfaqesimi, sipas nenit 153 ligjit 7638 dates

19.11.1992. Menyrat e thirrjes se asamblese ne mbledhje te zakonshme ose te jashtezakonshme dhe e pjesmarrjes se aksionereve, percaktohen ne statutin e saj. Mbledhja e zakonshme e Aksionereve ,thirret 1 here ne vit.

**Neni 10**

Organi qe ushtron kontroll te vazhdueshem mbi aktivitetin e shoqerise eshte Keshilli Mbykqyres. Ai zgjidhet nga Mbledhja e Aksionereve dhe perbehet nga tre anetare qe jane;

1. Adrian Çela, 2. Albert Kaçi, 3. Kostandinos Farmaçis.

Ne fillim te ushtrimit te aktivitetit, shoqeria mund te rrise numrin e anetareve te Keshillit Mbykqyres, per te siguruar pjesmarrjen ne masen prej 1/3 te tij nga ana e te punesuarve. Ne rast se nuk rritet numri I anetareve te Keshillit Mbykqyres, sigurimi I pjesmarrjes se te punesuarve do te behet brenda numrit tre te anetareve te Keshillit Mbykqyres. Kryetari I Keshillit Mbykqyres eshte zoti: Kostandinos Farmaçis. Kompetencat e Keshillit Mbykqyres dhe Kryetarit te saj percaktohen ne Statutin e shoqerise anonime.

**Neni 11**

Drejtimi I shoqerise kryhet nga drejtori I saj qe eshte zoti Arben Çela. Kompetencat, detyrat si dhe pergjegjesite e tij percaktohen ne statutin e shoqerise.

**Neni 12**

Fitimi ndahet midis aksionereve pasi me pare te jene zbritur detyrimet ndaj te treteve, humbjet e rezultuara etj si dhe te jete lene shuma e percaktuar per rezervim, krijimin e fondit rezerve sipas percaktimeve ne statut.

**Neni 13**

Ne te gjitha aktet e shoqerise, dokumentat e saj te destinuara per te trete, do te shenohen emrat e anetareve te Keshillit Mbykqyres dhe Drejtorit te saj.

**Neni 14**

.Shoqeria Anonime prishet:

- a. Me mbarimin e afatit percaktuar ne Akt Themelimi dhe Statut.
- b. Ne rast humbje aktivi kur kapitalet e saj behen me te vogla se  $\frac{1}{2}$  e kapitalit themeltar te saj dhe kur ajo shpallet nga Asambleja e jashtezakonshme, me pjesmarrjen e aksionereve, sipas kushteve te nenit 190, Ligjit 7638, dates 19.11.1992.
- c. Per cdo rast tjeter parashikuar shprehimisht ne Ligjin e mesiperme.

**Neni 15**

Kompetente per gjykimin e mosmarveshjeve midis aksionereve nese ato nuk zgjidhen me pajtim midis tyre, eshte gjykata e rrethit Tirane.  
**AKTI THEMELIMIT**, pasi lexohet nga palet, nenshkruhet nga ata pa asnje verejtje duke garantuar edhe respektimin e permbajtjes se tij.

**PALET**

1. Adrian Çela



2. Albert Kaçi,



3. Kostandinos Farmaçis





**STATUTI**  
**I SHOQËRISE ANONIME ME EMERTIMIN**  
**"PETROL GAZ"SH.A.**

I hartuar ne baze te Ligjit 7638 dates 19.11.19922,"Per shoqerite Tregetare", Ligjit 8450,dates 24.02.1999 " Per perpunimin,transportimin dhe tregetimin e naftes,te gazit dhe nenprodukteve te tyre"(neni 14),si dhe me vullnetin e lire te paleve

- 1.Adrian Çela,biri I Syrjait,dl.1968,lindur dhe banues ne Gjirokaster,
- 2.Albert Kaçi,biri I Kristaqit,dl.1967,lindur dhe banues ne Gjirokaster
- 3.Kostandinos Farmaqis,biri I Theofilaktos,dl.1963,lindur dhe banues ne Janine,Greqi,me permbajtjen si me poshte vijon:

**Neni 1**

Krijohet shoqeria anonime "PETROL GAZ"SH.A., pa oferte publike.

**Neni 2**

Objekti veprimtarise se shoqerise eshte:Tregeti import export,tregeti me shumice e pakice e hidrokarbureve,e gazit te lenget,servis per pajisjet e gazit,prodhim bombola gazi.

**Neni 3**

Qendra e veprimtarise se shoqerise eshte ne Jergucat,Gjirokaster.

**Neni 4**

Kohezgjatja e veprimtarise se saj eshte 15 vjet.Shoqeria do te filloje te ushtroje veprimtarine e saj ne Rep. Shqiperise,pas pajisjes me leje tregetimi sipas dispozitave te parashikuara ne ligjin 8450 dates 24.02.1999 dhe me license nga organet tatimore.

**Neni 5**

Kapitali themeltar I shoqerise anonime eshte 2.000.000 leke.Ai eshte shlyer me nenshkrimin ne kete statut, vertetohet nga certifikata e mbajtesit te fondeve,dhe ndahet ne aksione qe zoterohen nga aksioneret sipas kontributeve te shlyera,te shenuara ne listen e aksionereve, dhe konkretisht :

*Adrian Çela 33.33% e aksioneve.*

*Albert Kaçi 33.33% e aksioneve.*

*Kostandinos Farmaqis 33.34% e aksioneve.*

Vlefte nominale e aksioneve eshte 20.000 leke .

**Neni 6**

Aksioneret perballojne humbje te shoqerise deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

**Neni 7**

Organi me I larte I shoqerise anonime eshte Asambleja e Aksionereve.Ne mbledhjet e saj te zakonshme.,ajo mblidhet nje here ne vit.Vendimet e Asamblese se Aksionereve,merren dhe jane te vlefshme nese sigurohet pjesmarrja e jo me pak se 2/3 e e mbajtesve te aksioneve.Mbledhja e zakonshme vendos per ceshtjet e shoqerise me perjashtim te *a*)ndryshimeve ne Statut dhe *b*)prishjes se shoqerise.

Vendimet merren me shumice votash prej  $\frac{3}{4}$  e aksionereve te pranishem ose te perfaqesuar nga persona te vecante sipas nenit 135 te ligjit 7638 date 19.11.1992,(akt I vecante perfaqesimi)

Vetem Asambleja e jashtezakonshme vendos per ndryshimet ne Statut dhe per prishjen e shoqerise, si kompetenca ekskluzive te saj.

E drejta e votes, qe rjedh nga zoterimi aksioneve, eshte proporcionale me pjesmarrjen e kapitalit, qe perfaqeson dhe, cdo aksioner, I jep aksionerit te drejten e nje vote. Pjesmarrja e aksionereve ne mbledhje eshte e pakufizuar.

#### *Neni 8*

Nga mbledhja themeluese e Asamblese se Aksionereve, zgjidhet Keshilli Mbykqyres, I cili perbehet nga 3 anetare te percaktuar ne statut qe jane:

1. Adrian Çela, biri I Syrjait, dl. 1968, lindur dhe banues ne Gjirokaster.
2. Albert Kaçi, biri I Kristaqit, dl. 1967, lindur dhe banues ne Gjirokaster.
3. Kostandinos Farmaçis, biri I Theofilaktos, dl. 1963, lindur dhe banues ne Janine, Greqi.

*Keshilli Mbykqyres ka kompetenca:*

1. Verifikon, kontrollon, administrimin e sh.a. nga Drejtori saj, I cili paraqet raport nje here ne muaj.
2. Jep autorizim per marrveshjet midis shoqerive te tjera e shoqerise anonime, kur ne keto shoqeri , anetare te Keshillit Mbykqyres kane cilesi zoteruese.
3. Kontrollon llogarite e vitit financiar dhe paraqet verejtje mbi kete raport te paraqitur nga Drejtori ne Asamblene e Aksionereve.
4. Ben emerime te perkoheshme te anetarit te ri te Keshillit Mbykq. ne rast vdekje apo doreheqje te anetarit te vjeter dhe kerkon ratifikimin nga Mbledhja e afert e Aksionereve. Vendimet e Keshillit Mbykqyres merren me shumice votash. Anetaret e K.M. mund te shperblehen me shperblime te jashtezakonshme, por, jo me shperblime te perhershme, e drejte kjo vetem e anetarit te zgjedhur nga te punesuarit.

Anetareve te Keshillit Mbykq. u ndalohet:

- a) Te kontraktojne, te marrin hua nga shoqerija anonime, te japin paradhenie te behen dorezanes e te garantojne detyrimet ndaj te treteve.
- b) Te bejne publike te dhenat me karakter te brendshem te shoqerise.
- c) Te marrin pjese me kete cilesi ne me shume se dy Keshilla Mbykqyrese ne Republiken e Shqiperise.

Ata jane pergjegjes per gabimet personale te bera ne kohen e mandatit te tyre. U ndalohet anetareve te K.Mbykqyres te kene edhe cilesine e Drejtorit. Kohezgjatja e funksioneve te tyre percaktohet deri ne 3(tre)vjet.(neni 105), ligjit 7638 date 19.11.1992.

Mbledhjet e Keshillit Mbykqyres drejtohen nga Kryetari I saj, zoti Kostandinos Farmaçis.

#### *Neni 9*

Drejtori I shoqerise anonime eshte zoti Arben Çela.

*Kompetencat e Drejtorit jane:*

2. Le shon autorizime per kryerjen e disa operacioneve specifike.

3. Derrret mbledhjen e Asamblese se Aksionereve, percakton rendin e dites se mbledhjes, 15 dite para dates se caktuar.

4. Paraqet raport nje here ne 3 muaj para K.M. dhe brenda tre muajve nga dita e mbylljes se vitit financiar, paraqet llogarite vjetore.

5. Paraqet Raportet e ekspertit kontabel dhe cdo te dhene per anetaret qe emerohen rishtas ne Keshillim Mbykqyres.

#### *Neni 10*

Kontrolli financiar I shoqerise behet nga eksperti kontabel I autorizuar I emeruar nga Asambleja e Zakonshme, z. Kristaq Combi, (neni 93 Ligjit 7638, date 19.11.1992). Funksionet percaktohen e fillojne me emerimin e tij nga mbledhja e mesiperme dhe, mbarojne pas marrjes se vendimit per llogarite vjetore. Aksioneret qe perfaqesojne 1/10 e kapitalit themeltar kane te drejte brenda 30 diteve te kundershtojne ne gjykate ekspertin e emeruar.

*Kompetencat e ekspertit jane:*

1. Garanton rregullshmerine e llogarive vjetore dhe verifikon perputhjen me to te informacioneve te dhena ne raportin e administrimit nga ana e Drejtorit.

2. Verifikon respektimin e barazise se aksionereve.

3. Informon drejtorine dhe K.Mbykqyres per pjese te bilancit dhe dokumentave te kontabilitetit dhe perfundimet nga korregjimet e meparshme.

*Eksperti kontabel detyrohet:*

a) Te marre pjese ne mbylljen e llogarive te vitit financiar nga Drejtori.

b) Te sinjalizojte per pasaktesite e gjetura gjate plotesimit te detyres.

c) Te ruaje sekretin profesional.

d) Te pergjigjet ndaj shoqerise anonime per pasojat e demshme qe rjedhin nga veprimet e kryera me faj prej tij, gjate ushtrimit te detyres.

#### *Neni 11*

Fitimi, qe rezulton nga aktiviteti I shoqerise, do te ndahet midis aksionereve, ne perpjestim me vleren e aksioneve sipas kontributeve, te shlyera per krijimin e kapitalit themeltar dhe konkretisht:

1. Adrian Çela 33.33% 2. Albert Kaçi, 33.33% dhe 3. Kostandinos Farmaçis 33.34%.

#### *Neni 12*

Aksioneret caktojne fondin rezerve duke rezervuar 1/20 e fitimit vjetor. Kjo nuk eshte e detyrueshme kur ky fond arrin ne 1/10 e kapitalit themeltar.

#### *Neni 13*

Aksioni nominativ eshte lirisht I transferueshen kundrejt shenimit te transferimit ne librin e aksionereve te shoqerise anonime I cili plotesohet ne baze te klauzolave parashikuar nga neni 198 Ligjit 7638 dates 19.11.1992.

#### *Neni 14*

.Shoqeria anonime mund te bashkohet me shoqeri te tjera ose edhe te ndahet. Ligji 7638 ,dates 19.11.1992 percakton modalitetet perkatese per kete rast.

### Neni 15

Shoqeria anonime priset:

a.Me mbarimin e afatit parashikuar ne statut.

b.Ne rast humbje te aktivitet te saj,kur kapitalet behen me te vogla se  $\frac{1}{2}$  e kapitalit themeltar dhe, kur kjo shpallet nga Asambleja e jashtezakonshme e Aksionereve,sipas nenit 190 te Ligjit 7638 dates 19.11.1992.

c.Per cdo rast tjetër, parashikuar shprehimisht ne Ligjin e mesiperm.

### Neni 16

.Kompetente per zgjidhjen e mosmarveshjeve midis aksionereve, kur ato nuk mund te zgjidhen me pajtim midis tyre ,eshte gjykata e rrethit Tirane.

STATUTI, u gjet ne pajtim me vullnetin e lire te paleve pjesmarrese dhe nenshkruhet prej tyre, pa asnje verejtje .Per hartimin e tij, jane mbajtur parasysh dispozitat perkatese per shoqerite anonime ,kreu V,neni 74 e vijuesa te Ligjit 7638 dates 19.11.1999

### PALET

1. Adrian Çela

2. Albert Kaçi,

3. Kostandinos Farmaqis

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE

Nr 814 rep 285 kol.

### VERTETIM

Ne Tirane,ne zyren e noterise,sot ne date 29/01/1999,para meje noterese A. Meçaj paraqiten personalisht Adrian Çela,biri i Syrjaçit,d.l.1968,lindur dhe banues ne Gjirokaster,Albert Kaçi,biri i Kristaqit,d.l.1967,lindur dhe banues ne Gjirokaster,si edhe Kostandinos Farmaqis,biri i Theofilaktos,d.l.1963,lindur dhe banues ne Janine,Greqi,per identitetin e te cileve u njoha ne baze te ligjit,te cilet me vullnetin e tyre te lire kerkuan nga une vertetimin e nenshkrimeve te tyre ne aktin sa me siper.Pasi u binda se nenshkrimet e vena jane te tyret,vertetoj rregullisht.

NOTERE

NOTERE  
ARTEMISA MEÇAJ  
TIRANE

